

Të dhëna bazike të lëndës- SYLLABUSI	
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti	<i>Termoenergjetikë dhe Termoteknikë</i>
Titulli i lëndës:	Detalet e makinave
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II-të
Semestri:	III-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6.5
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asoc. dr.sc. Azem Kÿçyku
Detajet kontaktuese:	azem.kycyku@uni-pr.edu , 044-218-455, Kabineti 624 Konsultimet - 2 herë në javë nga një orë.
Përshkrimi i lëndës	
	Tolerancat, llojet dhe sistemet e vendosjeve. Llojet e ngarkesave. Filetot dhe lidhjet filetore. Llogaritjet e transmetuesve filetore dhe bulonave të grupeve të ndryshme. Sustat, llojet dhe përdorimi. Transmetuesit me rripa dhe zinxhirë. Transmetuesit me dhëmbëzorë, analiza e forcave të dhëmbëzorët. Boshtet dhe akset, kalkulimi paraprak dhe përfundimtarë i tyre. Dorëzat, përdorimi dhe kalkulimi. Kushinetat - llojet dhe kalkulimi i tyre. Lidhëset, llojet dhe kalkulimi.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me Detalet e makinave, të cilat përdoren në makina të ndryshme në përgjithësi. Kursi analizon në veçanti detalet, të cilat përdoren në konstruksionet e sistemeve të makinave prodhuese në industri, në sistemet termoenergjetike dhe mjeteve ndihmëse (mekanizmat e ngarkim – shkarkimit dhe transportit të brendshëm të mallrave etj).
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> - Detalet e makinave në përgjithësi t'i kuptojnë përkatësi formë, lloji, materiali dhe funksioni. - T'i kuptojnë mënyrat e veprimit të ngarkesave në detale të ndryshme gjatë funksionimit të makinave përkatëse. - Të bëjnë kalkulimin e detaleve nën veprimin e ngarkesave përkatëse.

	<ul style="list-style-type: none"> - Të dijnë të aplikojnë mënyrat e caktimit të shkallëve të sigurisë dhe afatshërbimit të detaleve vitale të makinave. - Për pjesët e studjuara në kurs të dijnë të zbatojnë metodat e përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinave sipas rregullave teknike. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	1	5	5
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	8	3	24
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	10	50
Përgaditja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
Totali			181 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime grafike, teste, diskutime.		
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)
	50		50
Literatura			
Literatura bazë:	[1]. Dr. sc. Nijazi Ibrahim, “Detalet e Makinave I”, Prishtinë 2004, [2]. Dr. sc. Nijazi Ibrahim, “Detalet e Makinave II”, Prishtinë 2006, [3].Dr. sc. Azem Kyçyku, “Përmbledhje e detyrave të zgjidhura nga Detalet e Makinave”, Prishtinë 2016. [4]. Dr.sc. Azem Kyçyku, “Udhëzimet e detyrave grafike nga Detalet e Makinave “ (Praktikum), Prishtinë 2016.		
Literatura shtesë:	[1]. Prof.dr.sc. S. Pershe & Doc.dr.sc. V. Vishnjac,		

	<p>“Strojarsstvo u prometu”, Zagreb 2005, [2]. Dr.sc. M. Nagode & Dr.sc. G. Fajdiga,” Strojni elementi”, Univerza v Ljubljani, [3]. Dr.sc. Z. Ren, “Strojni elementi”, Univerza v Mariboru.</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmasat e pjesëve makinerike, 2. Shmangiet dhe tolerancat, 3. Pozita e fushave toleruese, 4. Sistemet dhe llojet e vendosjeve,
Java e dytë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Llojet e ngarkesave, 2. Ndryshimi i ngarkesës varësisht nga koha, 3. Lakorja e lodhjes dhe qëndrueshmëria dinamike, 4. Shkalla e sigurisë,
Java e tretë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesët dhe parametrat e filetos, 2. Llojet e filetove, shënimi dhe përdorimi, 3. Ngarkesat dhe sforcimet e transmetuesve filetor, 4. Shtërngimi paraprak i lidhjeve me bulona dhe sforcimet, 5. Ngarkesa punuese e lidhjeve me bulona dhe sforcimet,
Java e katërt:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lidhjet me bulona – rasti III, IV dhe V, 2. Lidhjet me ribatina dhe procesi i ribatinimit, 3. Lidhjet e salduara dhe format e lidhjeve, Sustat, veçorit themelore dhe ndarja, 4. Gypat, veçorit themelore dhe materiali,
Java e pestë:	<p>Vlerësimi i parë Intermediar</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Transmetuesit dhe karakteristikat e tyre, 2. Transmetuesit me rripa, veçoritë e tyre dhe llojet, 3. Rripat trapezorë, forma dhe materiali, 4. Forcat dhe sforcimet në rripa
Java e gjashtë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kalkulimi i rripave trapezorë. 2. Transmetuesit me zinxhirë dhe veçoritë e tyre, 3. Kalkulimi i përmasave dhe forcat e çiftit me zinxhirë, 4. Zgjedhja e zinxhirit dhe vërtetimi i shkallëve të sigurisë,
Java e shtatë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Transmetuesit me dhëmbëzorë dhe ndarja e tyre, 2. Njohuritë e përgjithshme, llojet dhe përdorimi, 3. Madhsitë kryesore gjeometrike të dhëmbëzorëve cilindrik, konik dhe çiftit me vidhë pa fund, 4. Këndi I vijës së kontaktit, distance boshtore dhe shkalla e ingranimit të dhëmbëzorëve,
Java e tetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e forcave te dhëmbëzorët cilindrik me dhëmbë të pjerrët, 2. Analiza e forcave te dhëmbëzorët konik me dhëmbë

	<p>të drejtë,</p> <p>3. Analiza e forcave të çifti me vidhë pa fund,</p> <p>4. Çiftet me vidhë pa fund cilindrike,</p>
Java e nëntë:	<p>1. Njohuritë themelore mbi shkallën e sigurisë të anës së dhëmbëve të dhëmbëzorët,</p> <p>2. Njohuritë themelore mbi shkallën e sigurisë të rrënjës së dhëmbëve të dhëmbëzorët,</p> <p>Vlerësimi i dytë intermediar</p>
Java e dhjetë:	<p>1. Boshtet, akset dhe akset e vegjël,</p> <p>2. Kalkulimi paraprak dhe përfundimtar i boshteve (rasti i parë),</p> <p>3. Kalkulimi paraprak dhe përfundimtar i akseve,</p> <p>4. Kalkulimi i dorëzave radiale,</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>1. Lidhjet me kanale të boshteve me pjesët rrotulluese,</p> <p>2. Lidhjet me ndihmën e pykave pa dhe me pjerrësi të boshteve me pjesët rrotulluese,</p> <p>3. Kushinetat rrëshqitëse, ndarja, veçorit dhe lyerja e tyre</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>1. Kushinetat rrokullisëse, ndarja dhe veçorit e tyre,</p> <p>2. Bartja dinamike dhe statike kushinetave rrokullisëse,</p> <p>3. Ngarkesa ekuivalente të kushinetave rrokullisëse,</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>1. Zgjedhja e kushinetave sipas bartjes dinamike dhe statike,</p> <p>2. Lidhëset, ndarja dhe kalkulimi,</p>
Java e katërbëdhjetë:	<p>1. Lidhëset e pandashme, lidhëset me disqe,</p> <p>2. Lidhëset nyjore kardanike,</p> <p>3. Lidhëset e përshtatshme elastike me elemente jo metalike,</p>
Java e pesëmbëdhjetë:	<p>1. Lidhëset e ndashme, friksione.</p> <p>2. Vizita në Industri</p> <p>Vlerësimi i tretë Intermediar</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Gjatë semestrit me teste:</p> <p>Vlerësimi i parë intermediar: 27%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermediar: 27%</p> <p>Vlerësimi i tretë intermediar: 27%</p> <p>Detyrat grafike: 9%</p> <p>Vijimi i rregullt 10%</p> <p>Total 100%</p> <p>Notat:</p> <p>51-60 poena.....6 (gjashtë)</p> <p>61-70 poena.....7 (shtatë)</p> <p>71-80 poena.....8 (tetë)</p> <p>81-90 poena.....9 (nëntë)</p> <p>91-100 poena.....10 (dhjetë)</p>

	<i>Në fund të semestrit:</i>
--	-------------------------------------

	Provim me shkrim dhe me gojë.
--	-------------------------------